



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
TIRANË**

V E N D I M

Nr. 71 ,datë 27.12.2007

“PËR RIORGANIZIMIN E QËNDRËS KULTURORE “TIRANA”

Bazuar në ligjin Nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32, gërma “ç”, “ll”, ligjit Nr.8578, datë 10.02.2000 “Për teatrin”, kreu IV, neni 38, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.551, datë 07.11.2002 “Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore, për efekt page, përcaktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, pika 14, V.K.B. Nr.6, datë 21.03.2005 “Për riorganizimin e Teatrit të Cirkut, Teatrit të Estradës, Qendrës Rekreative Tiranë, në Qendrën Kulturore “Tirana” dhe nivelin e pagave të punonjësve”, V.K.B. Nr. 11, datë 05.02.2007 “Për një ndryshim në mënyrën e pagesës për orkestrën frymore dhe ansamblin Folklorik “Tirana”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.63, datë 06.12.2007 “Për disa ndryshime në nivelin e pagave të punonjësve të institucioneve të vartësisë”, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Të miratoje strukturën organizative të Qendrës Kulturore “Tirana”, me numër punonjësish (65), sipas organigramës bashkëlidhur.
2. Në vendimin Nr.63, datë 06.12.2007, Lidhja Nr.6, do të përcaktojë nivelin e pagave të punonjësve të Qendrës Kulturore “Tirana”, me ndryshimet sipas Tabelës Nr.1, bashkëlidhur.
3. Pika 1 e Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.11, datë 05.02.2007 “Për një ndryshim në mënyrën e pagesës për orkestrën frymore dhe Ansamblin Folklorik “Tirana”, ndryshon si më poshtë vijon:
**“Pagesa për muzikantët e Bandës së Qendres Kulturore “Tirana” të jetë 4.000 lekë për çdo aktivitet dhe jo më shumë se 24 aktivitete në vit.
Pagesa për dirigjentin e bandës së Qendres Kulturore “Tirana”, të jetë 10.000 lekë në muaj”.**
4. Pika 2 e Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.11, datë 05.02.2007 “Për një ndryshim në mënyrën e pagesës për Orkestrën Frymore dhe Ansamblin folklorik “Tirana”, ndryshon si më poshtë vijon:
“Pagesa për valltarë, këngëtarë dhe muzikantë të strukturës së Ansamblit të Qendres Kulturore “Tirana” të jetë 4.000 leke për çdo aktivitet dhe jo më shumë se 24 aktivitete në vit.

Pagesa për 1 Koreopetitor të jetë 10.000 lekë në muaj.

5. Efektet financiare të këtij vendimi do të fillojnë më 01.01.2008.
6. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Qendra Kulturore „Tirana“ për zbatimin e këtij Vendimi.
7. Ky Vendim hyn në fuqi më 1 janar 2008.

Sokol DERVISHAJ

K R Y E T A R I